



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

**NEON TOP WALL PAINT
(TOP HIDROMAT MURI)
BOJE PËR LYERJE MURI
Skedë Teknike**

PËRSHKRIMI: TOP WALL PAINT është një bojë e bardhë e pregatitur nga një emulsion i tipit “polimer (PVA) në ujë” e destinuar për lyerje muri dhe tavane që përveç rezinave dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushësa, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë karbonat kalciumi, hidroksietilcelulozë, talk, poliksiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, në kushte optimale boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, duke formuar një mbulesë të rrafshët, e cila ka rezistencë të lartë ndaj fërkimit dhe qëndrueshmëri ndaj dritës dhe ujit. Në sajë të porozitetit që ka, mbulesa është e depërtueshme nga gazet.

FUSHA E PËRDORIMIT: TOP WALL PAINT është e përdorshme në mjedise të brendëshme (mure,tavane), për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni.

NGJYRA: E bardhë.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Rekomandohet paraprakisht lyerja me astar PN – 301 ose PN – 101.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar TOP WALL PAINT. Doza e pigmentit që mund të përdoret, është sipas rekomandimit të prodhuesit. Për dorën e parë hollimi i bojës me ujë duhet të jetë deri në masën 15 - 20%. Ndërsa për dorën e dytë deri në masën 10%. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

NGJYRIMI: TOP WALL PAINT është e përshtatshme për të krijuar një gamë të gjërë bojrash me ngjyrë, duke përdorur 9 bazat ngjyruese NEON UNO COLOR PAINT dhe 9 bazat ngjyruese NEON RS COLOR PAINT, si dhe ngjyrimin nëpërmjet dozimit sipas sistemeve kompjuterike me 16 ngjyra

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk lejohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....E bardhë
- Imtësia.....40 – 45 μm
- Viskoziteti (30% ujë) Deep Cup 4.....22 – 26 sek
- Densiteti.....1.4 – 1.42 g/ml
- Fuqia mbuluese për lyerje të plotë.....4 – 5 m^2/L
- Mbetja e thatë..... $\leq 51\%$
- Koha e tharjes.....3 - 4 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC.Megjithatë kontakti me acidet dhe në temperatura mbi 800⁰C, bën që të çlirohet dioksid karboni.

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kova plastike 3L, 9L dhe 15L.

KUSHTET E RUAJTJES: Në ambalazh të mbyllur hermetikisht, të mbrojtur nga ngrica.